



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 433/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.06. 2018, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. *REF-59323-03-28-2018*, me objekt “*Shërbim i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë*”, me fond limit 125.263.882,5 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë.

Ankimues:

“Higjena” sh.p.k.
Rruga “Stiliano Thoma”, Kuçovë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kuçovë
Sheshi “18 Tetori”, Blloku “Tafil Skëndo”, Kuçovë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 29.03.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-59323-03-28-2018, me objekt “*Shërbim i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë*”, me fond limit 125.263.882,5 lekë (pa TVSH).

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, në datën 03.04.2018, operatori ekonomik ankimues “Higjena” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kriteret e kualifikimit e konkretisht:

[...] Ne datën 29.03.2018 është hedhur në sistemin elektronik DST për zhvillimin e procedurës së prokurimit të objektit Shërbimi i Pastrimit, Mbledhjes dhe Transportimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Kuçovë me Nr REF-59323-03-28-2018.

Duke ju referuar ketyre dokumentave verejme se ju si AK nuk keni zbatuar rekomandimet e KPP sipas Vendimit Nr. 806/2017. Gjithashtu keni bere nje sere shkeljesh te cilat do ti rendisim me poshte:

Sipas Ak: Ofertuesi duhet te disponoje minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e shërbimit, me qellim realizimin e objektit te prokurimit :

1	Makine teknologjike transportuese me kapacitet 9 - 10 ton	2 cope	Viti 2003
2	Makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër 3 - 5 ton	1 cope	
3	Autobot uji 7 – 10 ton	1 cope	Viti 2003

Përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktor Bashkia Kucove i vitit të prodhimit të makinerive është një kriter diskriminues dhe është në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPP-së. Makineritë kolaudohen nga kompania “SGS Albania” e cila përcakton nëse makina plotëson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave të motorit në ajër etj.,) sipas legjislacionit në fuqi për të qarkulluar në rrugët e Republikës së Shqipërisë. Kur makineritë kolaudohen në bazë të rregullave të përcaktuara në Manualin e Kontrollit të Mjeteve nga shoqëria “SGS Albania” atëherë këto makineri mund të përdoren në Republikën e Shqipërisë. Vendosja e vitit të prodhimit nga autoriteti kontraktor si kusht skualifikimi është një kriter diskriminues, i pabazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe LPP.

Gjithashtu i referohemi edhe Vendimit Nr. 748/2017 te KPP, i cili eshte shprehur per nje rast te njejte per vitin e prodhimit te mjeteve, konkretisht per sherbimin e Pastrimit ne Bashkine Mat, ku theksohet se: "Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se bindja e autoritetit kontraktor që operatorët ekonomikë pjesmarrës disponojnë kapacitetet e duhura teknike në lidhje me mjetet e transportit vërtetohet me anë të dokumentacionit përkatës të përcaktuar nga Ligji Nr. 83 78, datë 22. 7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë ” i ndryshuar; me anë të të cilit i krijohet tërësisht binaja autoritetit për plotësimin e këtij kriteri. Në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë, duke vendosur kërkesa në lidhje me disponimin e mjeteve dokumentacionin e kërkuar, sikurse specifikohet në legjislacionin në fuqi. AK duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë, duke arsyetuar dhe argumentuar ndryshimin, ashtu sikurse përcaktohet në nenin 61 te LPP.

Nga sa me siper theksojme se ju si AK nuk duhet te abuzoni me kerkesat e vitit te prodhimit te makinerive, per shkak te ndikimit ne mjedis, sepse vete ju jeni penguesit e pare te ruajtjes e permiresimit te mjedisit ne komunitet nepermjet pengesave qe krijoni ne drejtim te investimeve dhe zhvillimit te teknologjive te reja. Kjo per shkak te mos likujdimit ne kohe te faturave te sherbimeve te kryera per ju ndaj kontraktoreve, ne rastrin konkret ndaj firmes sone sipermarrese te sherbimit. Konkretisht borxhi juaj ndaj nesh si Operator eshte mbi 25 000 000 leke fatura te pa paguara per pune te kryer ne vitet e kaluara. Ju si AK ne Vendimin Nr.70 Dt. 22.12.2017 “Per Miratimin e Buxhetit vjetor 2018 ne Bashkine Kucove”, ne pasqyren e shpenzimeve te prapambetura theksoni se: Per pastrimin faturat e papaguara te mbartura nga vitet e kaluara, do te shlyhen deri ne vitin 2020.

Pra jeni ju qe pengoni investimet tona. te cilat do te permiresojne sherbimin ne komunitet. Nuk duam absolutisht te themi se qe meqenese Bashkia eshte debitore ndaj nesh, te jete tolerante duke na favorizuar ne kete procedure prokurimi. Por kerkojme thjesht zbatimin e dispozitave ligjore ne fuqi.

Prandaj kerkojme qe ky kriter te hiqet.

2. Ne lidhje me disponueshmerine e konteniereve AK eshte shprehur se: Operatori ekonomik duhet te disponojë minimalisht 280 (dyqind e tetëdhjetë) konteniere metalike ose zgjidhje ekuivalente me kapacitet minimal sipas sasise ditore qe do te evadohet, të jenë të përdorura apo te paricikluara. Nga keta 185 (njëqind e tetëdhjetë) konteniere do te vendosen ne perdorim qe ne lidhjen e kontrates dhe 95 (nëntëdhjetë e pesë) te tjere do te vendosen ne perdorim ne momentin qe do te behet shtrirja e sherbimit dhe ne Njesine Administrative Perondi, pas perfundimit te kontrates aktuale. Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë : Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e konteniereve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit, shoqeruar me specifikimet teknike dhe pamje fotografike nga vendodhja e tyre, si dhe adresen e vendodhjes se tyre. Vendodhja e tyre duhet te jetë ne një nga ambientet ku OE ushtron aktivitetin tregtar (magazinë e vetë OE, magazina me qira, apo dhënie në ruajtje tek të tretët (në këtë rast duhet ta konfirmojë me kontratë depozitimi dhe faturat e pagesës).

Kontenieret në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes.

Kontenieret e marra me qira financiare (leasing) apo të porositura duhet të shoqërohen me kontraten e porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes /afatin e ekzekutimit të porosisë (e vlefshme për vitin e pare te realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).

Për Kontenierët në pronësi, ose te porositur, Operatori ekonomik duhet të lejojë AK të kryejë verifikimin fizik te min. 30 % te sasise se kerkuar te konteniereve përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Në rast se Operatori ekonomik nuk i disponon kontenierët brenda periudhës së vlerësimit te ofertave, do të skualifikohet.

OE nuk duhet ti kete ne perdorim/ instaluara keto konteniere ne funksion te realizimit te nje kontrate ne fuqi apo te marra hua.

Ky kriter plotesohet me nje vetedeklarim dhe eshte subjekt verifikimi nga KVO.

Sa me siper verehet se AK kerkon disponueshmerine e 280 konteniereve nga te cilet 95 per nje zone qe hyn ne fuqi pas nje viti. Ky lloj kriteri eshte abuziv sepse OE nuk mund te mbaje 95 konteniere rezerve te cilet do te vendosen pas nje viti ne sherbim. Sasia e konteniereve duhet te jete e sakte dhe OE mund te plotesoje nje deklarate qe ne rast te nenshkrimit te kontrates si fitues pas një viti do të kompletojë edhe Njësinë Administrative Perondi me konteniere.

Kërkojmë që ky kriter të riformulohet.

Përsa i përket pikës b të kërkesave të konteniereve është kërkuar Akt Pronësie Origjinal si dhe faturat e blerjes.

Në lidhje me këtë pikë ju sqarojmë se për kontenierët nuk ka Akt Pronësie dhe se pronësia e tyre vërtetohet vetëm me faturën e blerjes. Prandaj kërkojmë ndryshimin e kësaj kërkesë.

Në pikën d të po këtyre kërkesave ju kërkon të verifikoni 30 % e kontenierëve gjatë periudhës së verifikimit të ofertave. Kjo pikë është arsyetuar edhe në vendimin nr. 673/2018 të KPP i cili shprehet se “kontenierët duhet të kërkojnë pas shpalljes së fituesit të operatorit ekonomik i cili është përgjegjës për zbatimin e kontratës”.

3. Ne procedurën e meperparshme ne si OE kemi kërkuar nga ju si AK që preventivat të ndryshohen dhe të paraqiten me sakte për çdo vit. Po kështu edhe për Analizat e kostos të këtyre modelim dhe përcaktim të sakte të të gjithë zerave të punës që ju kërkon. Por vërejmë se ju edhe rekomandimet e KPP nuk i keni respektuar. Konkretisht në DST që ju paraqitni jo vetëm që nuk i keni patur parasysh rekomandimet e KPP, por i keni thëlluar edhe me tepër me dashje gabimet. Në shtojtën 9 të specifikimit teknikë i keni ngaterruar me dashje që OE të mos jone të qarte për sa i përket volumeve të punës, ditëve të shërbimit etj.

- Studimin e pastrimit të fillonit me Bashkinë Kucovë dhe Njesinë Administrative Lumas. Në analizën e Kostos Nr.1 (fshirja me fshesa e rrugëve në gjithë qytetin për 167 000 m²), keni paraqitur inventarin e sipërfaqeve që do të fshihen por nuk përcaktoni sasinë e ditëve të punës që do të kryhen për këto shërbime gjatë një muaji dhe gjatë një viti. Po kështu edhe në Preventivin Përmbledhës mungon sasia vjetore e ditëve të punës që do të kryhen për këto shërbime.*
- Në Analizën e Kostos Nr.2 dhe Preventivin Përmbledhës për zerin (mbledhje dhe transporti i mbeturinave urbane) ju nuk keni përcaktuar sasinë mujore dhe vjetore të ditëve të punës.*
- Në Analizën e Kostos Nr.3 (shërbimi i pastrimit në ËC publike) ju nuk keni përcaktuar sasinë vjetore të ditëve të punës në muaj dhe në vit si në Analizën e Kostos dhe në Preventivin Përmbledhës.*
- Në Analizën e Kostos Nr. 4 (lagin e rrugëve dhe shesheve kryesore) ju keni përcaktuar ditët e punës vjetore për këto shërbime, por nuk pasqyrohen në Preventivin Përmbledhës.*
- Në Analizën e Kostos Nr.5 (heqja e mbetjeve solide nga pikat e grumbullimit) nuk përcaktohen ditët e punës mujore dhe vjetore si në Analizat e Kostos edhe në Preventivin Përmbledhës.*

Në njesinë Administrative Kozare vërehet se:

- Sipas grafikut të dhënë me tabele nga ana e juaj kërkohet që mbledhja dhe transporti i mbeturinave me kontenierë metalikë dhe mjet vetëshkarkues, të kryhen tre ditë në javë, që korrespondon me 156 ditë punë në vit ose 1248 orë punë. Në Analizat e Kostos për këto shërbime ju keni llogaritur 905 orë punë të barabarta me 113 ditë punë. Prandaj kërkojmë saktësimin e orëve dhe ditëve të punës si dhe pasqyrimin e tyre në Analizat e Kostos dhe në Preventivin Përmbledhës.*

Ne njesine Administrative Perondi:

- *Ne Analizen e Kostos Nr.1 (fshirja me fshese e rrugeve dhe trotuareve) keni paraqitur inventarin e siperfaqeve qe do te fshihen por nuk percaktoni sasine e diteve te punes qe do te kryhen per kete sherbim gjate nje viti. Po keshtu edhe ne Preventivin Permbledlës mungon sasia vjetore e diteve te punes qe do te kryhet ky sherbim.*
- *Ne Analizen e Kostos Nr.2 dhe Nr.3 Sipas grafikut te dhene me tabele nga ana e juaj kerkohet qe mbledhja dhe transporti i mbeturinave me kontenier metalike dhe mjet veteshkarkues, te kryhen tre dite ne jave qe korenspondon me 156 dite pune ne vit ose 1248 ore pune. Ne Analizat e Kostos per keto sherbime ju keni llogaritur 905 ore pune te barabarta me 113 dite pune. Prandaj kerkojme saktesimin e oreve dhe diteve te punes si dhe pasqyrimin e tyre ne Analizat e Kostos dhe ne Preventivin Permbledhes.*
- *Ne Specifikimet Teknike ne zerin (larja e konteniereve metalike), ku thuhet se do te kryhet larja e 95 cope kontenierte metalike 8 dite ne muaj. Do te lahen 48 cope kontenier metalike ne dite dhe per 2 dite 95 kontenier, ose 8 dite pune ne muaj. Gjithsej do te kryhen 96 dite pune ne vit. Ne Analizen e Kostos ju keni peraktuar 557 ore pune te barabarta me 70 dite pune ne vit pra nje diference nga specifikimet ne analizen e kostos prej 26 dite me pak. Prandaj kerkojme saktesimin e oreve dhe diteve te punes si dhe pasqyrimin e tyre ne Analizat e Kostos dhe ne Preventivin Permbledhes.*
- *Ne keto DST nuk eshte hedhur nga ana e juaj si AK Preventivi Permbledhes mbi te cilin Operatoret Ekonomike do te formulojne oferten, ne kete Preventiv duhet te percaktohen sakte te gjithe treguesit per zerat e sherbimit me njesi matese (m2, ton cope, ditepune), me sasine e plote mujore dhe vjetore te diteve te punes qe do te kryhen, cmimin per njesi, dhe vleren vjetore.*

PREVENTIV PËRMBLEDHËS

1. Fshirje me fshese dore e rrugeve dhe shesheve: _____ leke
2. Grumbullimi e transportimi i mbeturinaveurbane: _____ leke
3. Sherbim pastrimi ne ËC –te publike: _____ leke
4. Lagia e rrugeve dhe shesheve me mjet teknologjik: _____ leke
5. Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit: _____ leke

Shuma: _____ leke

TVSH 20% _____ leke

Shuma totale: _____ leke

Çmimet per njesi sipas analizave perkatese te kostos.

Nr.	Emertimi	Njesia	Çmimi per njesi
			(pa tvsh)
1.	Fshirje me fshese dore e rrugeve dhe shesheve	1 m ²	
2.	Grumbullim dhe transportim mbeturina ne vend depozitim	1 kont.	
		1 ton	
3.	Sherbim pastrimi ne ËC – te publike te qytetit	1 ëc	
4.	Lagije rruge dhe sheshe me mjet teknologjik	1 m ²	
5.	Heqje e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit	1 dite	

PREVENTIV PËRMBLEDHËS

(Njesia administrative Kozare)

1. Grumbullimi e transportimi i mbeturinave urbane _____

2. Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit _____

Shuma _____

T V S H 20%

Shuma totale = _____

Çmimet per njesi sipas analizave perkatese te kostos.

Nr.	Emertimi	Njesia	Çmimi per njesi
			(pa tvsh)
1.	Grumbullim dhe transportim mbeturina ne vend depozitim	1 kont.	
		1 ton	
2.	Heqje e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit	1 dite	

PREVENTIV PËRMBLEDHËS

(Njesia administrative Perondi)

1. Fshirja e rrugeve me fshese dore:

2. Grumbullimi e transportimi i mbeturinave urbane:

3. Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit:

4. Larja e konteniereve me mjet teknologjik:

TABELA PËRMBLEDHËSE E BASHKISË SË RE

Nr.	Emertimi	Çmimi (me tvsh)
1.	Bashkia Kucove dhe njesia Lumas	
2.	Njesia administrative Kozare	
3.	Njesia administrative Perondi	
	Shuma	

Nga sa analizuam me sipër ju si AK nuk e keni zbatuar ëndimin e KPP Nr.806/2017 i cili shprehet ekzaktesisht: "Në lidhje me preventivat, analizën e kostos, si edhe modelin e analizës së kostos, në dokumentat e tenderit Specifikimet teknike, në pikën 7.4. Rregulla për t'u zbatuar, pika 6, është përcaktuar: "Në ofertë OE duhet të paraqesë një analizë të ofertës së tij bazuar në formatin me kërkesat e analizës së Bashkisë. Në çdo rast përgjatë zhvillimit të procedurës AK rezervon të drejtën të kërkojë sqarime në lidhje me mënyrën e ndërtimit të ofertës së OE, pavarësisht nëse oferta e tij, rezulton ose jo anomalisht e ulët në lidhje me mënyrën e ndërtimit të tij, analizën, dokumentat mbështetëse, si pasqyra financiare, llogari, libra kontabël".

Gjithashtu në dokumentat e tenderit, në specifikimet teknike, janë përcaktuar analizat e kostos me përshkrimet përkatëse për Bashkinë Kuçovë.

Referuar sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, lidhur me preventivat për secilin vit, analizën e kostos, modelin e analizës së kostos, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të reflektojë duke bërë ndryshimet dhe modifikimet përkatëse në preventivat e publikuara, duke përcaktuar këto të dhëna për të gjitha zonat që përfshihen në Bashkinë Kuçovë për shërbimin e pastrimit, duke përshkruar dhe përcaktuar në të gjitha modelet, elementët dhe zërat kryesorë që do t'i shërbejnë operatorit ekonomik për hartimin e ofertës së tij, si edhe duke përfshirë edhe shtesat në shëm dhe ish komunitat.

Autoriteti kontraktor, në varësi të shërbimit që do të kryhet, referuar periudhës përkatëse në varësi edhe të zonave/njësive administrative që përfshihen në këtë shërbim si edhe të përfundimit të kontratave në vijim që janë për kryerjen e këtij shërbimi aktualisht, duhet të përcaktojë saktë zërat e punës, volume e tyre, e rrjedhimisht në varësi të tyre duhet të përcaktohet saktë edhe fondi limit, elementë këto shumë të rëndësishëm e të domosdoshëm për operatorin ekonomik në përgatitjen e ofertës së tij. Gjithashtu, edhe për analizën e kostos dhe modelin e kostos, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimet e duhura duke përcaktuar saktë analizat e modelet e analizës për secilën zonë, duke mos e lënë atë në përgjithësi dhe evasive".

Prandaj kerkojme korigjimin e te gjitha gabimeve te bera nga ana e juaj si dhe zbatimin e rekomandimeve te Vendimit te sipercituar.

Ju si AK keni sqaruar se (Për Njësinë Administrative Perondi, kontrata e re do të hyje në fuqi me mbarimin e kontratës ekzistuese në Prill 2019) . Preventivi për këtë Njësi, është përlllogaritur që nga mbarimi i afatit të kontratës ekzistuese deri në përfundim të kontratës së re, që do të lidhet me operatorin ekonomik fitues).

Pse ju si Autoritet nuk keni bere ndarjen e fondit limit per cdo vit? Si duhet ta ndajne kete fond Operoret ekonomike? Per derisa ju shpreheni se do te shtohen sherbimet e Njesise Administrative Perondi ne vitin 2019, pse nuk e keni pasqyruar edhe ne ndarjen e fondit limit? Duhet te jeni ju si AK ata qe bejne kete ndarje dhe mbi bazen e kesaj ndarjeje Operoret paraqesin Ofertat e tyre. Prandaj kerkojme ndarjen ekzakte te fondit nga ana e juaj per cdo vit mbeshtetur ne volumet e punes qe shtohen dhe kerkohen qe te kryhen.

Per sa me siper ne mbeshtetje te ligjit Nr.9643, date 20.11.2006, "Per prokurimin publik" i ndryshuar, VKM Nr.914, datë 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" kerkojme:

- 1. Te pezullohet procedura deri ne shqyrtimin e plote te ankeses perfshire edhe ankimin ne Komisionin e Prokurimit Publik.*
- 2. Te anulohet procedura e mesiperme, te saktesohen Preventivat, Analizat e Kostos dhe volumet e punes, ne vartesi te fondit limit qe do te prokurohet si dhe ndarjes ne vite.*
- 3. Te meren parasysh te gjitha kerkesat tona per modifikimin dhe saktesimin e kriterëve te vecanta.*

II.3. Operatori ekonomik ankimues sqaron se në datën 06.04.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës me nr. 1115/2 prot., datë 05.04.2018, duke e pranuar pjesërisht ankesën e paraqitur.

Konkretisht autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

Ne lidhje me argumentimin e OE per vitin e prodhimit të mjeteve jo me poshtë se 2003 , ju kujtojmë se procedura e rishpallur ne SPE vjen si pasojë e procedurës se pare dhe te dytë, ku e drejta juaj e ankimit është ezauruar dhe është refuzuar edhe nga vete KPP (Komisioni i Prokurimit Publik, me vendim Nr 643/2017, datë 06.09.2017 dhe vendim Nr. 806/2017, datë 29.12.2017.

[...]

2. Në lidhje me pikën e dytë: Mbi disponueshmerine e konteniereve : Ju sqarojmë si më poshtë : Nisur nga analiza e kosos e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve mbi ofrimin e Shërbimit të Pastrimit grumbullimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçove numri i kontenierëve të cilët nevojiten për kryerjen e shërbimit të mësipërm është i percaktuar në 280. Duke pasur parasysh se Bashkia Kuçove ka në përbërje të saj 3 ish Komuna të bashkangjitur nga Reforma Territoriale Administrative këtë shërbim do ta ofrojë në të gjithë territorin e saj dhe sasia e kërkuar përkon pikërisht me mbulimin e gjithë territorit me kontenier sipas nevoja ne cdo zone. Fakti qe ish Komuna Perondi sot Njesia Administrative Perondi Bashkia Kuçove ka nje kontrate aktive per Shërbimin e Pastrimit e cila perfundon ne Prill 2019 dhe kerkesa per disponueshmerine e konteniereve nga operatorët ekonomik ofertues ne numrin total te tyre nuk perben shkas per abuzim apo diskriminim por vetem tregon kapacitetin e tyre ne permbushje te nevoja te parashikuara nga Autoriteti Kontraktor sipas analizes se kosos te paraqitur ne DST. Fakti qe keta konteniere do te vendosen ne perdorim ne nje kohe te mevonshme nuk perben kriter diskriminues per operatorët ekonomik ofertues . Autoriteti Kontraktor e ka cilesuar qe nr. i ketyre konteniere do te vendosen ne perdorim ne perfundim te kontrates aktuale ne Njesine Administrative Perondi dhe kerkesa per disponueshmerine e tyre perben nje garanci per autoritetin kontraktor nga ana e operatorit ofertues dhe eshte ne proporcion te drejte me natyren dhe objektin e prokurimit .

Ne lidhje me kerkesen e akt pronesisë origjinal dhe fatures e blerjes sqarojme se te dy dokumentat jane dokumenta te percaktuara ligjerisht dhe te njohura prej ligjit. Akt pronesia origjinal apo i noterizuar eshte kontrata e shit-blerjes e cila percaktohet qartazi ne Kodin Civil.

Pasja e ketij dokumenti nuk eshte as kriter abuziv as anti ligjor , perkundrazi eshte nje dokumenti cili kerkohet ligjerisht per lidhjen e nje marreveshjeje per shit-blerjen e nje malli qe mund te realizohet perpara Noterit Publik ose nga vete subjektet juridike te cilet kane te drejta te lidhin kontrata sipas ligjit . Ne lidhje me faturen tatimore eshte nje dokument i cili tregon se eshte kryer trasaksioni i blerjes se mallit sipas kontrates se lidhur qe ne vetvete eshte akt pronesia origjinale apo e noterizuar .

Për sa me sipër kërkesa juaj nuk merret parasysh.

Ne lidhje me kërkesën për verifikimin e 30% të konteniereve gjatë vlerësimit të ofertave ju shpreheni se në vendimin 673/2017 (i cili nuk përkon me vendimet të cilët KPP është shprehur për procedurat e mëparshme në lidhje me shërbimet e pastrimit) kontenieret duhet të kërkojnë pas shpalles së fituesit i cili është përgjegjës për zbatimin e kontratës. Ju sqarojmë si më poshtë:

Autoriteti kontraktor shpjegon se kërkesa për kontenier është një kërkesë e cila duhet kërkuar që në Dokumentat Standarte të Tenderit si një kriter që duhet përmbushur nga operatorët ekonomik ol'ertues pasi në rast të kundërt do të bëhëj e perealizueshme objekti i kontratës për grumbullimin e mbetjeve urbane. Fakti që verifikimi deri në masën 30 % të numrit total të konteniervëve do të bëhet gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave nuk ka të bëjë me diskriminimin apo abuzimin nga AK pasi disponueshmëria e konteniervëve është një kriter i veçantë i cili është bazik në përmbushje të objektit të kontratës. Ky verifikim nga ana e AK bëhet duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë të objektit të kontratës dhe sigurinë e disponueshmërisë fizike të konteniervëve jo vetëm me letra siç është kërkuar në kriteret e DST.

3. Në lidhje me pikën tre :

Paragrafi i dytë

Në ankesë tuaj ju arsyetoni , studimin e pastrimit e filloni me Bashkinë Kuçovë dhe Njësinë Administrative Lumas. Në analizën e kostos Nr. 1 (fshirja me fshesë e rrugëve në gjithë qytetin për 167 000 m²), keni paraqitur inventarin e sipërfaqeve që do të fshihen por nuk përcaktoni sasinë e ditëve të punës që do të kryhen për këtë shërbim gjatë një muaji dhe gjatë një viti. Po kështu edhe në preventivin përmbledhës sasia vjetore e ditëve të punës që do të kryhen për këtë shërbim

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë te dokumentat standarte të tenderit, është fiksuar që fshirja me fshese dore të rrugëve dhe shesheve me sipërfaqja 167 000m² do të kryhet për 12 muaj ose 312 ditë pune në vit . Megjithatë në analizen e kostos nr 1 te fuqia punëtore ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej (16fshesare x 174 ore/muaj x 12 muaj) .

Në lidhje me paragrafin e tretë :

Në analizën e kostos nr 2 dhe Preventivin përmbledhës për zërin (mbledhje dhe transporti i mbeturinave urbane) ju nuk keni përcaktuar sasinë mujore dhe vjetore të ditëve të punës.

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë te dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që mbledhje dhe transporti i mbeturinave urbane do të kryhet për 12 muaj ose 312 ditë pune në vit. Megjithatë në analizën e kostos nr. 2 te fuqia punëtore III: ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej:

-Specialist (3 x 174 orë/muaj x 12 muaj)

-Punetore (6 x 174 orë/ muaj x 12 muaj)

Në lidhje me paragrafin e katërt :

Në analizën e kostos Nr.3 (shërbimi i pastrimit në ËC publike) ju nuk keni përcaktuar sasinë vjetore të ditëve të punës në muaj dhe në vit si në Analizën e kostos dhe në Preventivin Përmbledhës.

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë te dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që shërbimi i pastrimit në ËC publike do të kryhet për 12 muaj ose 312 ditë pune në vit . Megjithatë në analizën e kostos nr 3 te fuqia punëtore II : ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej :

-Punëtore (3 x 174 orë/muaj x 12 muaj)

Në lidhje me paragrafin e pestë :

Në analizën e kostos Nr.4 (lagia e rrugëve dhe shesheve kryesorë)ju keni përcaktuar ditët e punës vjetorë për këtë shërbim, por nuk i pasqyroni në Preventivin Përmbledhës .

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë te dokumentat standarte te tenderit , është fiksuar që (lagia e rrugëve dhe shesheve kryesorë për 12 muaj ose 220 ditë pune në vit .

Në lidhje me paragrafin e gjashtë:

Në analizën e kostos Nr.5 (heqja e mbetjeve solide nga pikat e grumbullimit) nuk përcaktohen ditët e punës mujore dhe vjetorë si në Analizat e Kostos edhe në Preventivin Përmbledhës .

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë të dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që heqja e mbetjeve solide nga pikat e grumbullimit do të kryhet për 12 muaj ose 312 ditë pune në vit . Megjithatë në analizen e kostos nr 5 te fuqia punëtore III : ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej :

-Specialist (1 x 174 orë/muaj x 12 muaj)

-Punëtore (2 x 174 orë/muaj x 12 muaj)

Në lidhje me paragrafin e shtatë :

Në Njësinë Administrative Kozare Sipas grafikut të dhënë në tabelë nga ana juaj kërkohet që mbledhja dhe transporti i mbeturinave me kontenier metalikë dhe mjet vetëshkarkues të kryhet tre ditë në javë që korespondon me 156 ditë pune në vit ose 1248 orë pune. Në analizat e kostos për këto shërbime ju keni llogaritur 905 orë punë të barabarta me 113 ditë pune. Prandaj kërkujmë saktësimin e orëve dhe të ditëve të punës si dhe pasqyrimin e tyre në analizat e kostos dhe në preventivin përmbledhës .

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë te dokumentat standarte të tenderit, është fiksuar që grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane në Njësinë Administrative Kozare do të ofrohet për tre ditë në javë ose 156 ditë në vit . Megjithatë në analizën e kostos nr 1 te fuqia punëtore III : ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej :

-Specialist (1 x 174 orë/muaj x 5.2 muaj), për 156 ditë pune në vit ose 5.2 muaj në vit .

-Punetore (2 x 174 orë/muaj x 5.2 muaj), për 156 ditë pune në vit ose 5.2 muaj në vit .

Në lidhje me paragrafin e tetë :

Në njësinë admisnistrative Perondi

Në analizën e kostos Nr.1 (fshirja me fshesë e rrugëve dhe trotuarëve) keni paraqitur inventarin e sipërfaqeve që do të fshihen por nuk përcaktoni sasinë e ditëve të punës që do të kryhen për këtë shërbim gjatë një viti . Po kështu edhe në preventivin përmbledhës mungon sasia vjetore e ditëve të punës që do të kryhet ky shërbim .

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë te dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që fshirja me fshesë dore të rrugëve dhe shesheve me sipërfaqja 29 800 m2 do të kryhet për 12 muaj ose 312 ditë pune në vit . Megjithatë në analizën e kostos nr 1 te fuqia punëtore ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej

-(4 fshesare x 174 orë/muaj x 12 muaj) .

Në lidhje me paragrafin e nëntë :

Në analizën e kostos Nr.2 dhe Nr.3 . Sipas grafikut të dhënë me tabelë nga ana juaj kërkohet që mbledhja dhe transporti i mbeturinave me kontenier metalikë dhe mjet vetëshkarkues, të kryhen tre ditë në javë që korespondon me 156 ditë punë në vit ose 1248 orë pune . Në analizat e kostos për këto shërbime ju keni llogaritur 905 orë punë të barabarta me 113 ditë pune . Prandaj kërkohet saktësimin e orëve dhe ditëve të punës si dhe pasqyrimin e tyre në analizat e kostos dhe në preventivin përmbledhës

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë të dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane në Njësinë Administrative Perondi do të ofrohet për tre ditë në javë ose 156 ditë në vit . Megjithatë në analizën e kostos nr 2 te fuqia punëtore III : ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej :

- Specialist (1 x 174 ore/muaj x 5.2 muaj), per 156 dite pune ne vit ose 5.2 muaj ne vit .*
- Punetore (2 x 174 ore/muaj x 5.2 muaj), per 156 dite pune ne vit ose 5.2 muaj ne vit*

Në lidhje me Paragrafin e dhjetë :

Ne specifikimet teknike ne zërin(larja e konteniereve metalikë) ku thuhet se dotë kryhet larja e 95 copë konteniereve metalike 8 ditë në muaj. Do të lahen 48 copë kontenier metalikë në ditë dhe per dy ditë 95 kontenier, ose 8 ditë pune në muaj. Gjithsej do të kryhen 96 ditë pune në vit. Në analizën e kostos ju keni përcaktuar 557 orë pune të barabarta me 70 ditë pune në vit pra një diferencë nga specifikimet në analizën e kostos prej 26 ditë më pak. Prandaj kërkohet saktësimin : orëve dhe ditëve të punës si dhe pasqyrimin e tyre në analizat e kostos dhe në preventivin përmbledhës.

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin. do e publikojmë me një shtojcë të dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që larja e konteniereve metalikë në Njësinë Administrative Perondi do të ofrohet për 8 ditë në muaj ose 96 ditë në vit . Megjithatë në analizën e kostos Nr.4 te fuqia punëtore III : ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej :

- Specialist (1 x 174 orë/muaj x 3.2 muaj), për 96 ditë pune në vit ose 3.2 muaj në vit .*
- Punetore (1 x 174 orë/muaj x 3.2 muaj), për 96 ditë pune në vit ose 3.2 muaj në vit*

Në lidhje me ndarjen e fondit limit për çdo vit

Ju sqarojmë si më poshtë :

Fondi limit është përlllogaritur në total për 4 vite duke parashikuar të gjitha volumet e punës që do të kryhen për Shërbimin e pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane. Hyrja në fuqi e Njesisë Administrative Perondi pas përfundimit të kontratës aktuale është e përcaktuar në analizën e kostos për volumin e punimeve që do të kryhen. I takon operatorëve ekonomik që të shprehen në lidhje me çmimet dhe vlerat që do të ofertojnë sipas zërave të kërkuar dhe nuk ka të bëjë me ndarjen apo mos ndarjen e fondit limit për të përcaktuar ofertën e operatorëve ekonomik .

Vendosi :

I. Të pranoj pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “ HIGJIENA ” SHPK , duke bere ndryshimet dhe sqarimet perkatese ne analizen e kostos dhe preventivin permbledhes .

Te mos pranoj ankesen per piken 1 dhe 2 ne faqen 53-54 te formularit te ankeses

Te informoje Autoritetin Kontraktor per vendimin e marre .

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere .

II.4. Në datën 12.04.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e depozituar pranë autoritetit kontraktor.

Në lidhje me kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor, ankimuesi sqaron se:

AK ne pergjigjen e tij me shkresen Nr.Prot 1115/2 Dt 05.04.2018 mare ne dorezim ne 06. 04.2018 shprehet se: “Ne formularin e cmimit te ofertes i cili do te publikohet me nje Shtojce ne DST, eshte fiksuar qe Fshirja me fshese dore e rrugve dhe shesheve me Sip. 167 000 m2 do te kryhet per 12 muaj ose 312 Dite pune ne vit. Megjithate ne Analizen e Kostos Nr.1 te fuqia Puntore ju e keni shume te sqaruar ore pune gjithsej (16 fshesare x 174 orë/muaj x 12 muaj.

Edhe pse AK ka bere kete sqarim, perseri nuk eshte i qarte dhe eshte teper kontradiktor me arsyetimin e tij ne lidhje me Analizat e kostos dhe kerkesat e tyre.

Konkretisht, ne Analizen e kostos Nr.1 te cilen e trajtuam me lart, per Fshirjen me fshese te sipërfaqes prej 167 000 m2, AK kerkon qe ky sherbim te kryhet ne 26 Dite pune ne muaj dhe 312 Dite pune ne vit. Ndryshe nga sa kerkon ne Analizen e Kostos se meposhtme publikuar nga AK ne DST kerkohet qe ky sherbim te kryhet per (22 DP ne muaj ose 261 DP ne vit, po ti referohemi pergjigjes se AK ne 6 Prill si dhe percaktimit qe ka bere ne Analizen e Kostos Nr.1 del se per kete sipërfaqe duhen 16 puntore x 174 Ore ne muaj x12muaj =33 408 ore pune ne vit.

Bazuar në këtë përlllogaritje të autoritetit kontraktor del se për çdo muaj duhet të kryhen 22 ditë pune në muaj me 8 orë në ditë sipas kodit të punës dhe për gjithë vitin 261 ditë pune.

Qëllimi i punës:

Pastrimi i sipërfaqes së përcaktuar nga punëtorë ditën dhe natën

I. Materiale:

- | | | | |
|--|--------|------------|--------------|
| • Karroca dore | cope | 4 x Cmim | = _____ leke |
| • Fshesa melakuqe | “ | 150 x Cmim | = _____ leke |
| • Fshesa xane | dengje | 305 x Cmim | = _____ leke |
| • Vegla pune (lopata, farashka,qese plastike) leke | | | = _____ leke |
| • Veshmbathje | pale | 16 x Cmim | = _____ leke |

Shuma = _____ leke

II. Fuqia punetore:

- Ore pune gjithsej (16x174ore/mx12m) 33 408 x Cmim l/ore = _____ leke
- Sigurime shoqerore 16.7% = _____ leke

Shuma = _____ leke

A. Shuma (I+II) = _____ leke

- Shpenzime plotesuese 4 % = _____ leke

Shuma = _____ leke

- E ardhura neto 10 % = _____ leke

Shuma = _____ leke

Mire po AK me gjithë se percakton ne Analize 22 dite pune ne muaj ose 261 ne vit, ne kthimin e pergjigjes shprehet per 26 dite pune ne muaj dhe 312 dite pune ne vit. Atehere per te kryer kete sherbim per 312 dite pune ne vit sic e kerkon AK, duke llogaritur me 8 ore pune sipas Kodit te Punes duhen 39 672 ore pune dhe jo 33 408 sic e percakton ne Analizen e Kostos dhe qe kerkon jo 16 punetore, por 19 puntore fshesar, pra 3 punetore me teper se sa kerkon ne Analize.

Qendruam gjate ne kete Arsyetim sepse AK ne te gjitha Analizat e kosros per cdo sherbim ka bere perlllogaritje te hollesishme duke percaktuar sasite e materialeve qe do te perdoren, qe nga fshesat deri tek normativ: e harxhimit te Karburantit per cdo automjet, por nuk ka llogaritur sakte fuqine punetore.

Eshte shqetesuese kjo per OE sepse ne strukturen e kosros se sherbimit te pastrimit fuqia puntore, pra pagat dhe shtesat mbi page zene mbi 50 '. te gjithë totalit te shpenzimeve. Nisur nga ky fakt kerkojme qe te rishikohen edhe njehere te gjitha analizat e kosros. duke percaktuar sakte dhe qarte dhe ne zbatim te Kodit te Punes. oret dhe ditet e punes per cdo sherbim.

[...]

Nga sa kemi theksuar më sipër, AK në përgjigjen e tij për të gjitha pikat e Analizave të kosros përsëri gabon sepse kërkon 26 ditë punë në muaj ose 312 punë në vit dhe po në analizat të cilave ju është referuar përcakton 22 ditë pune në muaj dhe 216 në vit. Po kështu edhe për shërbimet me 156 ditë pune në vit, kërkon më pak orë pune në ditë.

Pra ne si operatorë ekonomikë kërkojmë vetëm saktësimin e këtyre elementëve thelbësore të analizës së kosros ashtu si edhe në rekomandimet tuaja si KPP.

AK është shprehur në kthimin e përgjigjes se do ti reflektojë disa ndryshime të pjesshme me anë të një shtojce në SPE por deri në DT 11.04.2018 nuk ka bërë asnjë ndryshim dhe ne si operator nuk mund të presim që të kalojnë afatet e ankimit.

II.5. Në datën 25.04.2018, nëpërmjet shkresës me nr.1373/1 prot., datë 23.04.2018, me objekt: “Kthim përgjigje”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Higjena” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se kriteri: “Ofertuesi duhet te disponoje minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e shërbimit, me qellim realizimin e objektit te prokurimit :

1	Makine teknologjike transportuese me kapacitet 9 - 10 ton	2 cope	Viti 2003
2	Makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër 3 - 5 ton	1 cope	
3	Autobot uji 7 – 10 ton	1 cope	Viti 2003

Përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktor Bashkia Kucove i vitit të prodhimit të makinerive është një kriter diskriminues dhe është në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPP-së. Makineritë kolaudohen nga kompania “SGS Albania” e cila përcakton nëse makina plotëson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave të motorit në ajër etj.,) sipas legjislacionit në fuqi për të qarkulluar në rrugët e Republikës së Shqipërisë. Kur makineritë kolaudohen në bazë të rregullave të përcaktuara në Manualin e Kontrollit të Mjeteve nga shoqëria “SGS Albania” atëherë këto makineri mund të përdoren në Republikën e Shqipërisë. Vendosja e vitit të prodhimit nga autoriteti kontraktor si kusht skualifikimi është një kriter diskriminues, i pabazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe LPP. Gjithashtu i referohemi edhe Vendimit Nr. 748/2017 te KPP, i cili është shprehur për një rast të njëjtit për vitin e prodhimit të mjeteve, konkretisht për shërbimin e Pastrimit në Bashkinë Mat, ku theksohet se: “Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se bindja e autoritetit kontraktor që operatorët ekonomikë pjesmarrës disponojnë kapacitetet e duhura teknike në lidhje me mjetet e transportit vërtetohet me anë të dokumentacionit përkatës të përcaktuar nga Ligji Nr. 83 78, datë 22. 7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë ” i ndryshuar; me anë të të cilit i krijohet tërësisht binaja autoritetit për plotësimin e këtij kriteri. Në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë, duke vendosur kërkesa në lidhje me disponimin e mjeteve dokumentacionin e kërkuar, sikurse specifikohet në legjislacionin në fuqi. AK duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë, duke arsyetuar dhe argumentuar ndryshimin, ashtu sikurse përcaktohet në nenin 61te LPP, duhet të hiqet, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Nga informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor të depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se ky i fundit ka argumentuar: “*Ne lidhje me argumentimin e OE per vitin e prodhimit të mjeteve jo me poshtë se 2003 , ju kujtojmë se procedura e rishpallur ne SPE vjen si pasojë e procedurës se pare dhe te dytë, ku e drejta juaj e ankimimit është ezauruar dhe është refuzuar edhe nga vete KPP (Komisioni i Prokurimit Publik, me vendim Nr 643/2017, datë 06.09.2017 dhe vendim Nr. 806/2017, datë 29.12.2017”.*

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, shtojca 8, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 4 është përcaktuar kriteri:

- 1. Ofertuesi duhet te disponoje minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e shërbimit, me qëllim realizimin e objektit te prokurimit :*
- a. Makineritë qe duhet te disponoje shoqëria për realizimin e shërbimit, duhet te jene te plota dhe te pajisura me te gjithë aksesoret e nevojshëm e te mundshëm për te realizuar qëllimin dhe objektin e kontratave:*

<i>1</i>	<i>Makine teknologjike transportuese me kapacitet 9 - 10 ton</i>	<i>2 cope</i>
<i>2</i>	<i>Makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër 3 - 5 ton</i>	<i>1 cope</i>
<i>3</i>	<i>Autobot uji 7 – 10 ton</i>	<i>1 cope</i>

- a. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, me kapacitet mbajtës 9 - 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003, 2 (**dy**) **cope** (sipas tabelës se mesiperme nr 1)*
- b. Makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit, dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 3 - 5 ton dhe volum vaskë jo me te vogel se 5 m³, 1 (një) **cope**; (sipas tabelës se mesiperme nr 2)*
- c. Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet 7 – 10 litra, e vitit të prodhimit jo më poshtë se 2003. 1 (një) **cope** (sipas tabelës se mesiperme nr 3)*
- d. Të gjitha mjetet duhet te jene në pronësi ose me qira dhe te jene te shënuara në regjistra publikë. OE duhet te paraqesë dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit taksat.*

[...]

III.1.3. Në lidhje me vitin e prodhimit të mjeteve, KPP sqaron se ky pretendim është arsyetuar në vendimin KPP 643/2017, datë 06.09.2017, si edhe në vendimin KPP 806/2017, datë 29.12.2017, duke përbërë kështu një gjë të gjykuar, aq më tepër në kushtet kur ankimues ishte i njëjti operator ekonomik.

Në këto kushte, këtë pretendim të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik nuk do ta marrë në shqyrtim, pasi ky pretendim është arsyetuar dhe shqyrtuar në vendimet e sipërcituara.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik nuk qëndron në lidhje me këtë pikë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se “*Ne lidhje me disponueshmerine e konteniereve AK eshte shprehur se: Operatori ekonomik duhet te disponojë minimalisht 280 (dyqind e tetëdhjetë) konteniere metalike ose zgjidhje ekuivalente me kapacitet minimal sipas sasise ditore qe do te evadohet, të jenë të papërdorura apo te parieikluara. Nga keta 185 (njëqind e tetëdhjetë) konteniere do te vendosen ne perdorim qe ne lidhjen e kontrates dhe 95 (nëntëdhjetë e pesë) te tjere do te vendosen ne perdorim ne momentin qe do te behet shtrirja e sherbimit dhe ne Njesine Administrative Perondi, pas perfundimit te kontrates aktuale. Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë :*

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e konteniereve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit, shoqeruar me specifikimet teknike dhe pamje fotografike nga vendodhja e tyre, si dhe adresen e vendodhjes se tyre. Vendodhja e tyre duhet te jetë ne një nga ambientet ku OE ushtron aktivitetin tregtar (magazinë e vetë OE, magazina me qira, apo dhënie në ruatje tek të tretët (në këtë rast duhet ta konfirmojë me kontratë depozitimi dhe faturat e pagesës).

Kontenieret në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes.

Kontenieret e marra me qira financiare (leasing) apo të porositura duhet të shoqërohen kontraten e porosise (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes /afatin e ekzekutimit të porosisë (e vlefshme për vitin e pare te realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).

Për Kontejnerët në pronësi, ose te porositur, Operatori ekonomik duhet të lejojë AK të kryejë verifikimin fizik te min. 30 % te sasise se kerkuar te konteniereve përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Në rast se Operatori ekonomik nuk i disponon kontenierët brenda periudhes së vleresimit te ofertave, do të s kualifikohet.

OE nuk duhet ti kete ne perdorim/ instaluara keto konteniere ne funksion te realizimit te nje kontrate ne fuqi apo te marra hua.

Ky kriter plotesohet me nje vetedeklarim dhe eshte subjekt verifikimi nga KVO.

Sa me sipër verëhet se AK kerkon disponueshmerine e 280 kontenierve nga te cilet 95 per nje zone qe hyn ne fuqi pas nje viti. Ky lloj kriteri eshte abuziv sepse OE nuk mund te mbaje 95 konteniere rezerve te cilet do te vendosen pas nje viti ne sherbim. Sasia e konteniereve duhet te jete e sakte dhe OE mund te plotesoje nje deklarate qe ne rast te nenshkrimit te kontrates si fitues pas një viti do të kompletojë edhe Njësinë Administrative Perondi me konteniere.

Kërkojmë që ky kriter të riformulohet.

Përsa i përket pikës b të kërkesave të kontenierëve është kërkuar Akt Pronësie Origjinal si dhe faturat e blerjes.

Në lidhje me këtë pikë ju sqarojmë se për kontenierët nuk ka Akt Pronësie dhe se pronësia e tyre vërtetohet vetëm me faturën e blerjes. Prandaj kërkojmë ndryshimin e kësaj kërkesë.

Në pikën d të po këtyre kërkesave ju kërkon të verifikoni 30 % e kontenierëve gjatë periudhës së verifikimit të ofertave. Kjo pikë është arsyetuar edhe në vendimin nr. 673/2018 të KPP I cili shprehet se “kontenierët duhet të kërkohen pas shpalljes së fituesit të operatorit ekonomik i cili është përgjegjës për zbatimin e kontratës”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8, pika 3.3. Kapaciteti teknik, pika 9, është përcaktuar kriteri: “Operatori ekonomik duhet të disponojë minimalisht **280 (dyqind e tetëdhjetë)** konteniere metalike ose zgjidhje ekuivalente me kapacitet minimal sipas sasise ditore që do të evadohet, të jenë të përdorura apo të paricikluara. Nga këta **185 (njëqind e tetëdhjetë)** konteniere do të vendosen në përdorim që në lidhjen e kontratës dhe **95 (nëntëdhjetë e pesë)** të tjera do të vendosen në përdorim në momentin që do të behet shtrirja e shërbimit dhe në Njesinë Administrative Perondi, pas përfundimit të kontratës aktuale.

Disponueshmëria e tyre duhet të vërtetohet me dokumentacionin si më poshtë :

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e kontenierëve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit, shoqeruar me specifikimet teknike dhe pamje fotografike nga vendodhja e tyre, si dhe adresën e vendodhjes së tyre. Vendodhja e tyre duhet të jetë në një nga ambientet ku OE ushtron aktivitetin tregtar (magazinë e vetë OE, magazina me qira, apo dhënie në ruatje tek të tretët (në këtë rast duhet ta konfirmojë me kontratë depozitimi dhe faturat e pagesës).
- b) Kontenieret në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes.
- c) Kontenieret e marra me qira financiare (leasing) apo të porositura duhet të shoqërohen kontratën e porosisë (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes /afatin e ekzekutimit të porosisë (e vlefshme për vitin e parë të realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).
- d) Për Kontejnerët në pronësi, ose të porositur, Operatori ekonomik duhet të lejojë AK të kryejë verifikimin fizik të min. 30 % të sasise së kërkuar të kontenierëve përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Në rast se Operatori ekonomik nuk i disponon kontenierët brenda periudhës së vlerësimit të ofertave, do të s'kualifikohet.
- e) OE nuk duhet të ketë në përdorim/ instaluar këto konteniere në funksion të realizimit të një kontrate në fuqi apo të marra hua.

Ky kriter plotësohet me një vetedeklarim dhe është subjekt verifikimi nga KVO”.

III.2.2. Autoriteti kontraktor në dokumentacionin e paraqitur sqaron se:

2. Në lidhje me pikën e dytë: Mbi disponueshmërinë e kontenierëve : Ju sqarojmë si më poshtë : Nisur nga analiza e kostos e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve mbi ofrimin e Shërbimit të Pastrimit grumbullimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçove numri i kontenierëve të cilët nevojiten për kryerjen e shërbimit të mësipërm është i përcaktuar në 280. Duke pasur parasysh se Bashkia Kuçove ka në përbërje të saj 3 ish Komuna të bashkangjitur nga Reforma Territoriale Administrative këtë shërbim do ta ofrojë në të gjithë territorin e saj dhe sasia e kërkuar përkon pikërisht me mbulimin e gjithë territorit me kontenier sipas nevojës në çdo zonë.

Fakti që ish Komuna Perondi sot Njesia Administrative Perondi Bashkia Kucove ka një kontratë aktive për Sherbimin e Pastrimit e cila përfundon në Prill 2019 dhe kërkesa për disponueshmëri dhe konteniereve nga operatorët ekonomik ofertues në numrin total të tyre nuk përben shkas për abuzim apo diskriminim por vetëm tregon kapacitetin e tyre në përmbushje të nevojave të parashikuara nga Autoriteti Kontraktor sipas analizës së kostos të paraqitur në DST. Fakti që këta konteniere do të vendosen në përdorim në një kohë të mëvonshme nuk përben kriter diskriminues për operatorët ekonomik ofertues . Autoriteti Kontraktor e ka cilesuar që nr. i këtyre konteniereve do të vendosen në përdorim në përfundim të kontratës aktuale në Njesinë Administrative Perondi dhe kërkesa për disponueshmëri dhe tyre përben një garanci për autoritetin kontraktor nga ana e operatorit ofertues dhe është në proporcion të drejtë me natyrën dhe objektin e prokurimit .

Në lidhje me kërkesën e aktit pronësor origjinal dhe faturës e blerjes sqarohet se të dy dokumentat janë dokumenta të përcaktuara ligjrisht dhe të njohura prej ligjit. Akti pronësor origjinal apo i noterizuar është kontrata e shit-blerjes e cila përcaktohet qartazi në Kodin Civil. Pasja e këtij dokumenti nuk është as kriter abuziv as anti ligjor , përkundrazi është një dokumenti i cili kërkohet ligjrisht për lidhjen e një marrëveshjeje për shit-blerjen e një malli që mund të realizohet përpara Noterit Publik ose nga vetë subjektet juridike të cilët kanë të drejtë të lidhin kontratë sipas ligjit . Në lidhje me faturën tatimore është një dokument i cili tregon se është kryer transaksioni i blerjes së mallit sipas kontratës së lidhur që në vetvete është akti pronësor origjinal apo e noterizuar .

Për sa me sipër kërkesa juaj nuk merret parasysh.

Në lidhje me kërkesën për verifikimin e 30% të konteniereve gjatë vlerësimit të ofertave ju shprehemi se në vendimin 673/2017 (i cili nuk përkon me vendimet të cilët KPP është shprehur për procedurat e mëparshme në lidhje me shërbimet e pastrimit) kontenieret duhet të kërkohen pas shpalljes së fituesit i cili është përgjegjës për zbatimin e kontratës. Ju sqarohet si më poshtë:

Autoriteti kontraktor shpjegon se kërkesa për konteniere është një kërkesë e cila duhet kërkuar që në Dokumentat Standarte të Tenderit si një kriter që duhet përmbushur nga operatorët ekonomik ofertues pasi në rast të kundërt do të bëhet e përcaktueshme objekti i kontratës për grumbullimin e mbetjeve urbane. Fakti që verifikimi deri në masën 30 % të numrit total të konteniereve do të bëhet gjatë periudhës së vlerësimit të ofertave nuk ka të bëjë me diskriminimin apo abuzimin nga AK pasi disponueshmëria e konteniereve është një kriteri veçantë i cili është bazik në përmbushje të objektit të kontratës. Ky verifikim nga ana e AK bëhet duke pasur parasysh rëndësinë e veçantë të objektit të kontratës dhe sigurinë e disponueshmërisë fizike të konteniereve jo vetëm me letra siç është kërkuar në kriteret e DST”.

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për të njohur gjendjen e operatorëve ekonomikë, kapacitetet ekonomike, financiare, teknike e ligjore, me qëllim realizimin me sukses të kontratës, dhe nga ana tjetër përcaktimi dhe vendosja e kriterëve duhet të bëhet në përpjesëtim dhe në proporcion me natyrën dhe objektin e prokurimit.

Referuar sa më sipër, duke parë dhe vlerësuar në tërësi kriterin në lidhje me kontenierët, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, kriteri i vendosur dhe përcaktuar në këtë mënyrë, nënkupton faktin që për autoritetin kontraktor është e rëndësishme që të jepet garanci që mjetet disponohen me një nga format e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe krijon sigurinë e autoritetit kontraktor Bashkia Kuçovë për realizimin në kohë e me sukses të kontratës.

Nga ana tjetër, referuar edhe sqarimit të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është ky i fundit organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kritere që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në lidhje me kontenierët.

Autoriteti Kontraktor e ka cilësuar që numri i këtyre kontenierëve do të vendosen në përdorim në përfundim të kontratës aktuale në Njësinë Administrative Perondi dhe kërkesa për disponueshmërinë e tyre përbën një garanci për autoritetin kontraktor nga ana e operatorit ofertues dhe është në proporcion të drejtë me natyrën dhe objektin e prokurimit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

III.2.4. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes përsa i përket përcaktimit në pikën “b” e “d” të këtij kriteri, konkretisht: *b) Kontenieret në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar si dhe me faturat tatimore të blerjes.*

d) Për Kontejnerët në pronësi, ose të porositur, Operatori ekonomik duhet të lejojë AK të kryejë verifikimin fizik të min. 30 % të sasisë së kërkuar të kontenierëve përgjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Në rast se Operatori ekonomik nuk i disponon kontenierët brenda periudhës së vlerësimit të ofertave, do të s’kualifikohet, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se:

III.2.4.1. Kjo procedurë prokurimi vjen në vazhdimësi të procedurës së prokurimit *Procedurë e Hapur*, me objekt *“Shërbim i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë”* me Nr. REF 29588-10-12-2017, me fond limit 128.883.334 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 04.11.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë, e cila është anuluar në zbatim të vendimit të KPP 806/2017, datë 29.12.2017, pra është anuluar procedura me nr. REF – 29588-10-12-2017, dhe është ripublikuar procedura me nr. REF-59323-03-28-2018, me objekt *“Shërbim i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë”*, me fond limit 125.263.882,5 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë. Sa më sipër, këto dy procedura janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën, përsa kohë që, nuk ka përfunduar shqyrtimi i ankesës dhe nuk është hequr ende pezullimi i procedurës së parë, për shkak se gjatë verifikimit të dokumentacionit të ripublikuar nga ana e autoritetit kontraktor në zbatim të vendimit të KPP 806/2017, datë 29.12.2017, është paraqitur ankesa nga operatori ekonomik “Higjena” sh.p.k.

Në këto kushte, kur kemi të bëjmë me të njëjtën procedurë prokurimi, por të rihedhura, dokumentat pas modifikimit të dokumentave të tenderit në zbatim të vendimit KPP 806/2017, datë 29.12.2017, sqarojmë se këto dy përcaktime në lidhje me kontenierët kanë qenë të njohura për operatorin ekonomik që në krye të herës kur është publikuar procedura me nr. REF – 29588-10-12-2017, duke sjellë si pasojë edhe humbjen e afateve procedurale për ngritje pretendimesh për kritere që

kanë qenë të njohura nga ana e operatorit ekonomik, që në datën e publikimit të kësaj procedure prokurimi (13.10.2017), jemi në kushtet kur kemi të bëjmë me të njëjtën procedurë prokurimi, me dokumenta standarte të tenderit të rihedhura e modifikuara në zbatim të vendimit të KPP-së, pas shqyrtimit të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Higjena” sh.p.k., aq më tepër, në kushtet kur kemi të bëjmë edhe me të njëjtin operator ekonomik.

Sa më sipër këto pretendime të operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se: *“Ne proceduren e meperparshme ne si OE kemi kërkuar nga ju si AK qe preventivat te ndryshohen dhe te paraqiten me sakte per cdo vit. Po keshtu edhe per Analizat e kostos të ketë modelim dhe percaktim te sakte te te gjithë zerave te punes qe ju kerkoni. Por verejme se ju edhe rekomandimet e KPP nuk i keni respektuar. Konkretisht ne DST qe ju paraqitni jo vetem qe nuk i keni patur parasysh rekomandimet e KPP, por i keni thelluar edhe me teper me dashje gabimet. Ne shtojen 9 te specifikimet teknike i keni ngaterruar me dashje qe OE te mos jene te qarte per sa i perket volumeve te punes, diteve te sherbimit etj.*

- *Studimin e pastrimit e filloni me Bashkine Kucove dhe Njesine Administrative Lumas. Ne analizen e Kostos Nr.1 (fshirja me fshesa e rrugeve ne gjithë qytetin per 167 000 m2), keni paraqitur inventarin e siperfaqeve qe do te fshihen por nuk percaktoni sasine e diteve te punes qe do te kryhen per kete sherbim gjate nje muaji dhe gjate nje viti. Po keshtu edhe ne Preventivin Permbledhes mungon sasia vjetore e diteve te punes qe do te kryhen per kete sherbim.*
- *Ne Analizen e Kostos Nr.2 dhe Preventivin Permbledhes per zerin (mbledhje dhe transporti i mbeturinave urbane) ju nuk keni percaktuar sasine mujore dhe vjetore te diteve te punes.*
- *Ne Analizen e Kostos Nr.3 (sherbimi i pastrimit ne ËC publike) ju nuk keni percaktuar sasine vjetore te diteve te punes ne muaj dhe ne vit si ne Analizen e Kostos dhe ne Preventivin Permbledhes.*
- *Ne Analizen e Kostos Nr. 4 (lagin e rrugeve dhe shesheve kryesore) ju keni percaktuar ditet e punes vjetore per kete sherbim, por nuk pasqyroni ne Preventivin Permbledhes.*
- *Ne Analizen e Kostos Nr.5 (heqja e mbetjeve solide nga pikat e grumbullimit) nuk percaktohen ditet e punes mujore dhe vjetore si ne Analizat e Kostos edhe ne Preventivin Permbledhes.*

Ne njesine Administrative Kozare verehet se:

- *Sipas grafikut te dhene me tabele nga ana e juaj kerkohet qe mbledhja dhe transporti i mbeturinave me kontenler metalike dhe mjet veteshkarkues, te kryhen tre dite ne jave, qe korenspondon me 156 dite pune ne vit ose 1248 ore pune. Ne Analizat e Kostos per keto sherbime ju keni llogaritur 905 ore pune te barabarta me 113 dite pune. Prandaj kerkojme sakesimin e oreve dhe diteve te punes si dhe pasqyrimin e tyre ne Analizat e Kostos dhe ne Preventivin Permbledhes.*

Ne njesine Administrative Perondi:

- *Ne Analizen e Kostos Nr.1 (fshirja me fshese e rrugeve dhe trotuareve) keni paraqitur inventarin e siperfaqeve qe do te fshihen por nuk percaktoni sasine e diteve te punes qe do te kryhen per kete sherbim gjate nje viti. Po keshtu edhe ne Preventivin Permbledlës mungon sasia vjetore e diteve te punes qe do te kryhet ky sherbim.*
- *Ne Analizen e Kostos Nr.2 dhe Nr.3 Sipas grafikut te dhene me tabele nga ana e juaj kerkohet qe mbledhja dhe transporti i mbeturinave me kontenier metalike dhe mjet veteshkarkues, te kryhen tre dite ne jave qe korenspondon me 156 dite pune ne vit ose 1248 ore pune. Ne Analizat e Kostos per keto sherbime ju keni llogaritur 905 ore pune te barabarta me 113 dite pune. Prandaj kerkojme sakesimin e oreve dhe diteve te punes si dhe pasqyrimin e tyre ne Analizat e Kostos dhe ne Preventivin Permbledhes.*
- *Ne Specifikimet Teknike ne zerin (larja e konteniereve metalike), ku thuhet se do te kryhet larja e 95 cope kontenierte metalike 8 dite ne muaj. Do te lahen 48 cope kontenier metalike ne dite dhe per 2 dite 95 kontenier, ose 8 dite pune ne muaj. Gjithsej do te kryhen 96 dite pune ne vit. Ne Analizen e Kostos ju keni peraktuar 557 ore pune te barabarta me 70 dite pune ne vit pra nje diference nga specifikimet ne analizen e kostos prej 26 dite me pak. Prandaj kerkojme sakesimin e oreve dhe diteve te punes si dhe pasqyrimin e tyre ne Analizat e Kostos dhe ne Preventivin Permbledhes.*
- *Ne keto DST nuk eshte hedhur nga ana e juaj si AK Preventivi Permbledhes mbi te cilin Operatoret Ekonomike do te formulojne oferten, ne kete Preventiv duhet te percaktohen sakte te gjithe treguesit per zerat e sherbimit me njesi matese (m2, ton cope, ditepune), me sasine e plote mujore dhe vjetore te diteve te punes qe do te kryhen, cmimin per njesi, dhe vleren vjetore. [...]*

Nga sa analizuam me siper ju si AK nuk e keni zbatuar ëndimin e KPP Nr.806/2017 i cili shprehet ekzaktesisht: "Në lidhje me preventivat, analizën e kostos, si edhe modelin e analizës së kostos, në dokumentat e tenderit Specifikimet teknike, në pikën 7.4. Rregulla për t'u zbatuar, pika 6, është përcaktuar: "Në ofertë OE duhet të paraqesë një analizë të ofertës së tij bazuar në formatin me kërkesat e analizës së Bashkisë. Në çdo rast përgjatë zhvillimit të procedurës AK rezervon të drejtën të kërkojë sqarime në lidhje me mënyrën e ndërtimit të ofertës së OE, pavarësisht nëse oferta e tij, rezulton ose jo anomalisht e ulët në lidhje me mënyrën e ndërtimit të tij, analizën, dokumentat mbështetëse, si pasqyra financiare, llogari, libra kontabël".

Gjithashtu në dokumentat e tenderit, në specifikimet teknike, janë përcaktuar analizat e kostos me përshkrimet përkatëse për Bashkinë Kuçovë.

Referuar sa më sipër, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, lidhur me preventivat për secilin vit, analizën e kostos, modelin e analizës së kostos, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të reflektojë duke bërë ndryshimet dhe modifikimet përkatëse në preventivat e publikuara, duke përcaktuar këto të dhëna për të gjitha zonat që përfshihen në Bashkinë Kuçovë për shërbimin e pastrimit, duke përshkruar dhe përcaktuar në të gjitha modelet, elementët dhe zërat kryesorë që do t'i shërbejnë operatorit ekonomik për hartimin e ofertës së tij, si edhe duke përfshirë edhe shtesat në shëm dhe ish komunat.

Autoriteti kontraktor, në varësi të shërbimit që do të kryhet, referuar periudhës përkatëse në varësi edhe të zonave/njësive administrative që përfshihen në këtë shërbim si edhe të përfundimit të kontratave në vijim që janë për kryerjen e këtij shërbimi aktualisht, duhet të përcaktojë saktë zërat e punës, volume e tyre, e rrjedhimisht në varësi të tyre duhet të përcaktohet saktë edhe fondi limit, elementë këto shumë të rëndësishëm e të domosdoshëm për operatorin ekonomik në përgatitjen e ofertës së tij. Gjithashtu, edhe për analizën e kostos dhe modelin e kostos, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimet e duhura duke përcaktuar saktë analizat e modelet e analizës për secilën zonë, duke mos e lënë atë në përgjithësi dhe evasive”.

Prandaj kerkojme korigjimin e te gjitha gabimeve te bera nga ana e juaj si dhe zbatimin e rekomandimeve te Vendimit te sipercituar.

Ju si AK keni sqaruar se (Për Njësine Administrative Perondi, kontrata e re do të hyje në fuqi me mbarimin e kontratës ekzistuese në Prill 2019). Preventivi për këtë Njësi, është përlllogaritur që nga mbarimi i afatit të kontratës ekzistuese deri në përfundim të kontratës së re, që do të lidhet me operatorin ekonomik fitues).

Pse ju si Autoritet nuk keni bere ndarjen e fondit limit per cdo vit? Si duhet ta ndajne kete fond Operatoret ekonomike? Per derisa ju shpreheni se do te shtohen sherbimet e Njesise Administrative Perondi ne vitin 2019, pse nuk e keni pasqyruar edhe ne ndarjen e fondit limit? Duhet te jeni ju si AK ata qe bejne kete ndarje dhe mbi bazen e kesaj ndarjeje Operatoret paraqesin Ofertat e tyre. Prandaj kerkojme ndarjen ekzakte te fondit nga ana e juaj per cdo vit mbeshtetur ne volumet e punes qe shtohen dhe kerkohen qe te kryhen, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues, sqaron se:

3. Në lidhje me pikë tre :

Paragrafi i dytë

Në ankesë tuaj ju arsyetoni , studimin e pastrimit e filloni me Bashkinë Kuçovë dhe Njësine Administrative Lumas. Në analizën e kostos Nr. 1 (fshirja me fshesë e rrugëve në gjithë qytetin për 167 000 m2), keni paraqitur inventarin e sipërfaqeve që do të fshihen por nuk përcaktoni sasinë e ditëve të punës që do të kryhen për këtë shërbim gjatë një muaji dhe gjatë një viti. Po kështu edhe në preventivin përmbledhës sasia vjetore e ditëve të punës që do të kryhen për këtë shërbim

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë te dokumentat standarte të tenderit, është fiksuar që fshirja me fshese dore të rrugëve dhe shesheve me sipërfaqja 167 000m2 do të kryhet për 12 muaj ose 312 ditë pune në vit . Megjithatë në analizen e kostos nr 1 te fuqia punëtoreju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej (16fshesare x 174 ore/muaj x 12 muaj).

Në lidhje me paragrafin e tretë :

Në analizën e kostos nr 2 dhe Preventivin përmbledhës për zërin (mbledhje dhe transporti i mbeturinave urbane) ju nuk keni përcaktuar sasinë mujore dhe vjetore të ditëve të punës.

Ju sqarohet si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë të dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që mbledhje dhe transporti i mbeturinave urbane do të kryhet për 12 muaj ose 312 ditë pune në vit. Megjithatë në analizën e kostos nr. 2 të fuqia punëtore III: ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej:

-Specialist (3 x 174 orë/muaj x 12 muaj)

-Punetore (6 x 174 orë/ muaj x 12 muaj)

Në lidhje me paragrafin e katërt :

Në analizën e kostos Nr.3 (shërbimi i pastrimit në ËC publike) ju nuk keni përcaktuar sasinë vjetore të ditëve të punës në muaj dhe në vit si në Analizën e kostos dhe në Preventivin Përmbledhës . Ju sqarohet si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë të dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që shërbimi i pastrimit në ËC publike do të kryhet për 12 muaj ose 312 ditë pune në vit . Megjithatë në analizën e kostos nr 3 të fuqia punëtore II : ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej :

-Punëtore (3 x 174 orë/muaj x 12 muaj)

Në lidhje me paragrafin e pestë :

Në analizën e kostos Nr.4 (lagia e rrugëve dhe shesheve kryesorë)ju keni përcaktuar ditët e punës vjetore për këtë shërbim, por nuk i pasqyroni në Preventivin Përmbledhës .

Ju sqarohet si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë të dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që (lagia e rrugëve dhe shesheve kryesorë për 12 muaj ose 220 ditë pune në vit .

Në lidhje me paragrafin e gjashtë:

Në analizën e kostos Nr.5 (heqja e mbetjeve solide nga pikat e grumbullimit) nuk përcaktohen ditët e punës mujore dhe vjetore si në Analizat e Kostos edhe në Preventivin Përmbledhës .

Ju sqarohet si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë të dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që heqja e mbetjeve solide nga pikat e grumbullimit do të kryhet për 12 muaj ose 312 ditë pune në vit . Megjithatë në analizen e kostos nr 5 të fuqia punëtore III : ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej :

-Specialist (1 x 174 orë/muaj x 12 muaj)

-Punëtore (2 x 174 orë/muaj x 12 muaj)

Në lidhje me paragrafin e shtatë :

Në Njësinë Administrative Kozare Sipas grafikut të dhënë në tabelë nga ana juaj kërkohet që mbledhja dhe transporti i mbeturinave me kontenier metalikë dhe mjet vetëshkarkues të kryhet tre ditë në javë që korespondon me 156 ditë pune në vit ose 1248 orë pune. Në analizat e kostos për këto shërbime ju keni llogaritur 905 orë punë të barabarta me 113 ditë pune. Prandaj kërkohet saktësimin e orëve dhe të ditëve të punës si dhe pasqyrimin e tyre në analizat e kostos dhe në preventivin përmbledhës .

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë te dokumentat standarte të tenderit, është fiksuar që grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane në Njësinë Administrative Kozare do të ofrohet për tre ditë në javë ose 156 ditë në vit . Megjithatë në analizën e kostos nr 1 te fuqia punëtore III : ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej :

-Specialist (1 x 174 orë/muaj x 5.2 muaj), për 156 ditë pune në vit ose 5.2 muaj në vit .

-Punetore (2 x 174 orë/muaj x 5.2 muaj), për 156 ditë pune në vit ose 5.2 muaj në vit .

Në lidhje me paragrafin e tetë :

Në njësinë administrative Perondi

Në analizën e kostos Nr.1 (fshirja me fshesë e rrugëve dhe trotuarëve) keni paraqitur inventarin e sipërfaqeve që do të fshihen por nuk përcaktoni sasinë e ditëve të punës që do të kryhen për këtë shërbim gjatë një viti . Po kështu edhe në preventivin përmbledhës mungon sasia vjetore e ditëve të punës që do të kryhet ky shërbim .

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë te dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që fshirja me fshesë dore të rrugëve dhe shesheve me sipërfaqja 29 800 m2 do të kryhet për 12 muaj ose 312 ditë pune në vit . Megjithatë në analizën e kostos nr 1 te fuqia punëtore ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej

-(4 fshesare x 174 orë/muaj x 12 muaj) .

Në lidhje me paragrafin e nëntë :

Në analizën e kostos Nr.2 dhe Nr.3 . Sipas grafikut të dhënë me tabelë nga ana juaj kërkohet që mbledhja dhe transporti i mbeturinave me kontenier metalikë dhe mjet vetëshkarkues, të kryhen tre ditë në javë që korespondon me 156 ditë punë në vit ose 1248 orë pune . Në analizat e kostos për këto shërbime ju keni llogaritur 905 orë punë të barabarta me 113 ditë pune . Prandaj kërkohet saktësimin e orëve dhe ditëve të punës si dhe pasqyrimin e tyre në analizat e kostos dhe në preventivin përmbledhës

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin, do e publikojmë me një shtojcë te dokumentat standarte të tenderit, është fiksuar që grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve urbane në Njësinë

Administrative Perondi do të ofrohet për tre ditë në javë ose 156 ditë në vit . Megjithatë në analizën e kostos nr 2 te fuqia punëtore III : ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej :

-Specialist (1 x 174 ore/muaj x 5.2 muaj), per 156 dite pune ne vit ose 5.2 muaj ne vit .

-Punetore (2 x 174 ore/muaj x 5.2 muaj), per 156 dite pune ne vit ose 5.2 muaj ne vit

Në lidhje me Paragrafin e dhjetë :

Ne specifikimet teknike ne zërin(larja e konteniereve metalikë) ku thuhet se dotë kryhet larja e 95 copë kontcnirve metalike 8 ditë në muaj. Do të lahen 48 copë kontenier metalikë në ditë dhe per dy ditë 95 kontenier, ose 8 ditë pune në muaj. Gjithsej dotë kryhen 96 ditë pune në vit. Në analizën e kostos ju keni përcaktuar 557 orë pune të barabarta me 70 ditë pune në vit pra një diferencë nga specifikimet në analizën e kostos prej 26 ditë më pak. Prandaj kërkojmë saktësimin : orëve dhe ditëve të punës si dhe pasqyrimin e tyre në analizat e kostos dhe në preventivin përmbledhës.

Ju sqarojmë si më poshtë :

Në formularin e çmimit të ofertës të cilin. do e publikojmë me një shtojcë të dokumentat standarte të tenderit , është fiksuar që larja e konteniereve metalikë në Njësinë Administrative Perondi do të ofrohet për 8 ditë në muaj ose 96 ditë në vit . Megjithatë në analizën e kostos Nr.4 te fuqia punëtore III : ju e keni shumë të sqaruar orë pune gjithsej :

-Specialist (1 x 174 orë/muaj x 3.2 muaj), për 96 ditë pune në vit ose 3.2 muaj në vit .

-Punetore (1 x 174 orë/muaj x 3.2 muaj), për 96 ditë pune në vit ose 3.2 muaj në vit

Në lidhje me ndarjen e fondit limit për çdo vit

Ju sqarojmë si më poshtë :

Fondi limit është përlllogaritur në toral për 4 vite duke parashikuar të gjitha volumet e punës që do të kryhet për Shërbimin e pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane. Hyrja në fuqi e Njësisë Administrative Perondi pas përfundimit të kontratës aktuale është e përcaktuar në analizën e kostos për volumnin e punimeve që do të kryhen. I takon operatorëve ekonomik që të shprehen në lidhje me çmimet dhe vlerat që do të ofertojnë sipas zërave të kërkuar dhe nuk ka të bëjë me ndarjen apo mos ndarjen e fondit limit për të përcaktuar ofertën e operatorëve ekonomik .

[...].

III.3.2. Operatori ekonomik ankimues, në lidhje me kthimin e përgjigjes së autoritetit kontraktor për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga ankimuesi pranë tij, argumenton se:

AK ne pergjigjen e tij me shkresen Nr.Prot 1115/2 Dt 05.04.2018 mare ne dorezim ne 06. 04.2018 shprehet se: “Ne formularin e cmimit te ofertes i cili do te publikohet me nje Shtojce ne DST, eshte fiksuar qe Fshirja me fshese dore e rrugve dhe shesheve me Sip. 167 000 m2 do te kryhet per 12 muaj ose 312 Dite pune ne vit. Megjithate ne Analizen e Kostos Nr.1 te fuqia Puntore ju e keni shume te sqaruar ore pune gjithsej (16 fshesare x 174 orë/muaj x 12 muaj.

Edhe pse AK ka bere kete sqarim, perseri nuk eshte i qarte dhe eshte teper kontradiktor me arsyetimin e tij ne lidhje me Analizat e kostos dhe kerkesat e tyre.

Konkretisht, ne Analizen e koston Nr.1 te cilen e trajtuam me lart, per Fshirjen me fshese te sipërfaqes prej 167 000 m², AK kerkon qe ky sherbim te kryhet ne 26 Dite pune ne muaj dhe 312 Dite pune ne vit. Ndryshe nga sa kerkon ne Analizen e Koston se meposhtme publikuar nga AK ne DST kerkohet qe ky sherbim te kryhet per (22 DP ne muaj ose 261 DP ne vit, po ti referohemi pergjigjes se AK ne 6 Prill si dhe percaktimit qe ka bere ne Analizen e Koston Nr.1 del se per kete sipërfaqe duhen 16 puntore x 174 Ore ne muaj x12muaj =33 408 ore pune ne vit.

Bazuar në këtë përlllogaritje të autoritetit kontraktor del se për çdo muaj duhet të kryhen 22 ditë pune në muaj me 8 orë në ditë sipas kodit të punës dhe për gjithë vitin 261 ditë pune.

Qëllimi i punës:

Pastrimi i sipërfaqes së përcaktuar nga punëtorë ditën dhe natën

I. Materiale:

- Karroca dore cope 4 x Cmim = _____ leke
 - Fshesa melakuqe “ 150 x Cmim = _____ leke
 - Fshesa xane dengje 305 x Cmim = _____ leke
 - Vegla pune (lopata, farashka,qese plastike) leke = _____ leke
 - Veshmbathje pale 16 x Cmim = _____ leke
- Shuma = _____ leke

II. Fuqia punetore:

- Ore pune gjithsej (16x174ore/mx12m) 33 408 x Cmim l/ore = _____ leke
- Sigurime shoqerore 16.7% = _____ leke

Shuma = _____ leke

B. Shuma (I+II) = _____ leke

- Shpenzime plotesuese 4 % = _____ leke

Shuma = _____ leke

- E ardhura neto 10 % = _____ leke

Shuma = _____ leke

Mire po AK me gjithë se percakton ne Analize 22 dite pune ne muaj ose 261 ne vit, ne kthimin e pergjigjes shprehet per 26 dite pune ne muaj dhe 312 dite pune ne vit. Atehere per te kryer kete sherbim per 312 dite pune ne vit sic e kerkon AK, duke llogaritur me 8 ore pune sipas Kodit te Punes duhen 39 672 ore pune dhe jo 33 408 sic e percakton ne Analizen e Koston dhe qe kerkon jo 16 puntore, por 19 puntore fshesar, pra 3 puntore me teper se sa kerkon ne Analize.

Qendruam gjate ne kete Arsyetim sepse AK ne te gjitha Analizat e koston per cdo sherbim ka bere perlllogaritje te hollesishme duke percaktuar sasite e materialeve qe do te perdoren, qe nga fshesat deri tek normativ: e harxhimit te Karburantit per cdo automjet, por nuk ka llogaritur sakte fuqine punetore.

Eshte shqetesuese kjo per OE sepse ne strukturen e koston se sherbimit te pastrimit fuqia puntore, pra pagat dhe shtesat mbi page zene mbi 50 % te gjithë totalit te shpenzimeve.

Nisur nga ky fakt kerkojme qe te rishikohen edhe njehere te gjitha analizat e kostos. duke percaktuar sakte dhe qarte dhe ne zbatim te Kodit te Punes. oret dhe ditet e punes per cdo sherbim. [...]

Nga sa kemi theksuar më sipër, AK në përgjigjen e tij për të gjitha pikat e Analizave të kostos përsëri gabon sepse kërkon 26 ditë punë në muaj ose 312 punë në vit dhe po në analizat të cilave ju është referuar përcakton 22 ditë pune në muaj dhe 216 në vit. Po kështu edhe për shërbimet me 156 ditë pune në vit, kërkon më pak orë pune në ditë.

Pra ne si operatorë ekonomikë kërkojmë vetëm saktësimin e këtyre elementëve thelbësore të analizës së kostos ashtu si edhe në rekomandimet tuaja si KPP.

AK është shprehur në kthimin e përgjigjes se do ti reflektojë disa ndryshime të pjesshme me anë të një shtojce në SPE por deri në DT 11.04.2018 nuk ka bërë asnjë ndryshim dhe ne si operator nuk mund të presim që të kalojnë afatet e ankimimit.

III.3.3. Në nenin 12, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij”.

III.3.4. Në nenin 9 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “Vlera limit e kontratës publike është shuma totale, pa TVSH, e llogaritur nga autoriteti kontraktor përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit. Në llogaritjen e vlerës merret parasysh edhe shuma totale që duhet paguar në rast ripërtëritjeje të kontratës, kur një rasti tillë është parashikuar. Kjo vlerë ka për qëllim klasifikimin e kontratës sipas kufijve monetarë dhe planifikimin e publikimit e procedurës së prokurimit. Vlera e TVSH-së llogaritet si zë më vete, por nuk përfshihet në vlerën limit të publikuar në njoftimin e kontratës. TVSH-ja, kur është e zbatueshme, i shtohet vlerës së ofertës fituese për llogaritjen e vlerës totale të kontratës që do të lidhet.

2. Për kontratat shumëvjeçare ose kontratat me mundësi ripërtëritjeje, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë klauzola për rishikimin e vlerës, në përputhje me inflacionin e publikuar. Në rastet e kontratave të furnizimit të mallrave, përmes qirasë apo leasing, fondi limit llogaritet duke përfshirë qiranë apo këstin mujor, shumëzuar me numrin e muajve, gjatë të cilave do të zgjatë kontrata”.

III.3.5. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, është autoriteti kontraktor organi përgjegjës për përcaktimin e nevojave të tij për mallra, shërbime e pune, duke përcaktuar për secilën prej tyre sasi të përkatëse dhe të duhura sipas nevojave të tij, specifikimet teknike të tyre, preventivin me llojin e mallit/shërbimit/punës, pra duke përcaktuar zërat përkatës, e në vijim të tyre duke përcaktuar edhe fondin limit për një objekt të caktuar prokurimi. Pra, është përgjegjësi e autoritetit kontraktor, si organi me interes të drejtëpërdrejtë për kryerjen e procedurës së prokurimit, si edhe organi përgjegjës për mirëpërdorimin e fondeve publike, të përcaktojë fondin limit të një procedure prokurimi, në përputhje me sasi të domosdoshme për plotësimin e nevojave të tij. Në rastin konkret, përsa i përket zërave dhe elementëve konkretë, për të cilat nga ana e operatorit ekonomik kërkohet saktësimi i tyre në përputhje me përcaktimet e bëra në secilën tabelë

në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se autoriteti kontraktor, duhet të bëjë përcaktimet e sakta, në mënyrë që të mos krijojë konfuzion dhe paqartësi, si tek operatorët ekonomikë gjatë hartimit të ofertës, ashtu edhe tek komisioni i vlerësimit të ofertave më pas, gjatë procesit të shqyrtimit të ofertave. Në lidhje me fondin limit, autoriteti kontraktor, ka sqaruar e detajuar se *Fondi limit është përlogaritur në total për 4 vite duke parashikuar të gjitha volumet e punës që do të kryhet për Shërbimin e pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve urbane. Hyrja në fuqi e Njesisë Administrative Perondi pas përfundimit të kontratës aktuale është e përcaktuar në analizën e kostos për volumin e punimeve që do të kryhen. I takon operatorëve ekonomik që të shprehën në lidhje me çmimet dhe vlerat që do të ofertojnë sipas zërave të kërkuar dhe nuk ka të bëjë me ndarjen apo mos ndarjen e fondit limit për të përcaktuar ofertën e operatorëve ekonomik.* Pra, autoriteti kontraktor, ka bërë përlogaritjen e fondit limit, duke u nisur nga përlogaritjet dhe ndarjet e zërave dhe volumeve të punës.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik në fuqi, përcaktimi i kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, si edhe përcaktimi i specifikimeve teknike, preventivave përkatës me zërat dhe elementët e duhur, duhet të jetë i saktë, i qartë, në mënyrë që edhe operatori ekonomik të bazohet në të dhëna të sakta gjatë hartimit të ofertës së tij.

III.3.7. Në lidhje me pretendimet dhe kërkesën e operatorit ekonomik për saktësimin e këtyre elementëve thelbësore të analizës së kostos, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP, konstaton se, autoriteti kontraktor nuk ka publikuar shtojcën përkatëse, edhe pse ka vendosur pranimin e pjesshëm të pretendimit të operatorit ekonomik ankimues, pra ky fakt nuk është reflektuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e autoritetit kontraktor (shtojcë e dokumenteve të procedurës së prokurimit) në lidhje me vendimarrjen e autoritetit kontraktor. Megjithatë, Komisioni i Prokurimit Publik, nuk mund të anashkalojë faktin se, pretendimi i mësipërm është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe në lidhje me këtë të fundit nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, por në zbatimin e këtij vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor, krahas konstatimeve të vendimarrjes së K.P.P. duhet të pasqyrojë njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit, për aq sa është pranuar prej autoritetit kontraktor. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, autoriteti kontraktor përveç publikimit të shtojcës përkatëse për sqarimet e duhura të cilat janë pranuar prej tij, duhet të bëjë këto modifikime në përputhje me konstatimet e vendimit të KPP 806/2017, datë 29.12.2017, si edhe duke pasur për bazë pretendimet dhe konstatimet e ngritura në lidhje me disa mospërputhje edhe pas kthimit të përgjigjes, të operatorit ekonomik ankimues, referuar ankesës së paraqitur pranë KPP-së.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.


Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Higjena” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-59323-03-28-2018, me objekt “Shërbim i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë”, me fond limit 125.263.882,5 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 23.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kuçovë.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Higjena” sh.p.k.
 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 739 Protokolli

Datë 12.04.2018



KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Kryetar
Evis Shurdha